

Promovimi i Intermodalitetit dhe Rilindja Hekurudhore në Rajonin Adriatiko-Jonian

Në kuadrin e programit Interreg ADRIION 2014-2020, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise është partnere në projektin: “Intermodality Promotion and Rail Renaissance in Adriatic–Ionian Region”/Inter-Connect.

Projekti ka filluar implementimin ne 1 Janar 2018 me kohëzgjatje 24 muaj deri ne 31 Dhjetor 2019.

Projekti Inter-Connect ka si qëllim kërkimin e zgjidhjeve të reja të përshtatura për specifikat e ADRIION, për promovimin e transportit intermodal dhe udhëzimin e aktorëve respektiv mbi mënyrën se si të zbatojnë në praktikë objektivat e konektivitetit. Qasja e projektit lidhet me identifikimin e shtyllave të tashme dhe të ardhme që lidhen me transportin, përdorimin e anketave për nevojat e lëvizshmërisë, draftimin e një harte për përdoruesit e mjeteve, ndërtimin e skemave të bashkëpunimit, masat e buta të lëvizshmërisë, shqyrtimin e mundësive të financimit dhe hartimin e një roadmap.

Partnerët në këtë projekt, së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, janë Bashkia Igumenicë, Qendra Hellas për Kërkim dhe Teknologji (CERTH), Greqi, Instituti i Transportit dhe Logjistikës (ITL), Rajoni Emilia-Romagna (RER), Agjencia për Zhvillim Rajonal e Rajonit Urban të Lubjanës (RRA LUR), Shoqëria “HZ Passenger Transport” Ltd. (HZPP), Porti i Bar-it, Mal i Zi dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Beograd.

Në kuadër të këtij projekti, do të hartohet një studim mbi zhvillimin dhe implementimin e innovation technology për transportin intermodal- Informimi në kohë reale i udhëtarëve përmes harmonizimit të orareve të udhëtimeve në rrugë dixhitale, për udhëtarët që përdorin transportin detar, hekurudhor dhe kur është e nevojshme edhe transportin ajror. Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i transportit intermodal midis hekurudhës dhe porteve dhe potencialisht edhe me llojet e tjera të transportit, veçanërisht atyre që lidhin rajonin e Tiranës me Durrësin. Kjo zgjidhje teknologjike do të zhvillohet për të pasqyruar kryesisht informacionin lidhur me udhëtimin, në anijet, trenat dhe avionët, me mundësinë e zgjerimit të fushës së udhëtimit dhe vendndodhjeve, në një moment të dytë. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të promovojë përdorimin e transportit intermodal përmes kanaleve të ndryshme duke përfshirë faqen e internetit të saj, panaiet shqiptare të turizmit, faqet e internetit të turizmit shqiptar, TIA, etj. Ky informacion i orareve dixhitale do të lejojë të huajt dhe / ose shqiptarët që kthehen nga udhëtimet e tyre, që të kenë informacionin e nevojshëm në kohë reale në mënyrë që të planifikojnë dhe koordinojnë lëvizjet e tyre në mënyrë më efektive dhe efikente.